



Shpjegime për plotësimin e kërkesës për pension të siguruarit nga Fondi Gjerman i Pensioneve (Formulari AL / DE 1)

E nderuar kërkuese / i nderuar kërkuës,

për të vendosur mbi kërkesën tuaj për një pension gjerman është e nevojshme që t'ju përgjigjeni pyetjeve në formularin e aplikimit.

Këto shpjegime kanë për qëllim t'ju ndihmojnë në plotësimin e formularit të aplikimit. Ju lutemi lexojini ato me kujdes dhe përgjigjuni të gjitha pyetjeve në fjalë në formularin e aplikimit sa më plotësisht të jetë e mundur. Në këtë mënyrë mund të shmangen vonesa të panevojshme në përpunimin e aplikimit.

Sikurse thuhet në shënimet shpjeguese, kërkesës i duhen bashkëlidhur prova (dëshmi) të caktuara.

Pasi ta keni plotësuar aplikimin, dërgojeni atë menjëherë. Mos e mbani atë pa dërguar për shkak se ende duhet të plotësoni dokumentacionin. Dokumentet e mbetura mund t'i dërgoni më vonë. Ju lutemi bëni me dije se dokumentacioni do të vijojë.

Datën e aplikimit, të dhënat për të siguruarin dhe fëmijët mund t'i konfirmoni (vërtetoni) në pjesën J pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

Me respekt
Fondi juaj Gjerman i Pensioneve

Pjesa A (Informacione mbi të siguruarin)

Pikat 1 dhe 3 (Numri i Sigurimit)

Ju lutemi që brenda mundësive të shënoni si numrin gjerman ashtu edhe atë shqiptar të sigurimeve shoqërore në mënyrë që kërkesa t'i caktohet institucionit kompetent të sigurimit të pënsioneve.

Ju lutem mos harroni që edhe në të gjitha shkresat e ardhshme të shënoni numrin gjerman të sigurimeve.

Në pikat 8 dhe 11 nuk është e nevojshme të paraqitet **dëshmia** nëse Instituti i Sigurimeve Shoqërore vërteton të dhënat në pjesën J.

Pika 8 (Datëlindja)

Ju lutemi bashkëlidhni një certifikatë origjinale lindje ose kopje të certifikuar të saj, nëse jo ende nuk na është dorëzuar.

Erläuterungen zum Ausfüllen des Antrages auf Versichertenrente aus der Deutschen Rentenversicherung (Formblatt AL / DE 1)

Sehr geehrte Antragstellerin / Sehr geehrter Antragsteller,

um über Ihren Antrag auf eine deutsche Rente entscheiden zu können, ist die Beantwortung der Fragen im Antragsvordruck erforderlich.

Diese Erläuterungen sollen Ihnen beim Ausfüllen des Antragsvordrucks helfen. Bitte lesen Sie diese sorgfältig durch und beantworten Sie alle Sie betreffenden Fragen im Antragsvordruck so vollständig wie möglich. Dadurch können unnötige Verzögerungen in der Bearbeitung Ihres Antrags vermieden werden.

Wie in den Erläuterungen ausgeführt, müssen Sie dem Antrag bestimmte Beweismittel beifügen.

Wenn Sie den Antrag ausgefüllt haben, reichen Sie ihn bitte unverzüglich ein. Halten Sie ihn nicht deswegen zurück, weil Sie noch Unterlagen beschaffen wollen. Die fehlenden Unterlagen können Sie nachschicken. Weisen Sie bitte darauf hin, dass noch Unterlagen folgen.

Den Tag der Antragstellung, die Angaben zum Versicherten und zu den Kindern können Sie sich im Teil J vom Institut der Sozialversicherung bestätigen lassen.

Mit freundlichen Grüßen
Ihr Rentenversicherungsträger

Teil A (Angaben zum Versicherten)

Punkte 1 und 3 (Versicherungsnummern)

Bitte geben Sie hier nach Möglichkeit sowohl die deutsche als auch die albanische Sozialversicherungsnummer an, damit Ihr Antrag dem zuständigen Rentenversicherungsträger zugeordnet werden kann.

Vergessen Sie bitte nicht, auch auf allen zukünftigen Schreiben die deutsche Versicherungsnummer anzugeben.

Ein **Nachweis** zu den Punkten 8 und 11 ist nicht erforderlich, wenn das Institut der Sozialversicherung die Angaben im Teil J bestätigt.

Punkt 8 (Geburtsdatum)

Bitte fügen Sie uns eine Geburtsurkunde im Original oder in beglaubigter Kopie bei, sofern diese uns noch nicht vorgelegen hat.

Pika 11 (Shtetësia)

Si dëshmi e shtetësisë suaj të tanishme, ju lutemi paraqisni një nga dokumentet e mëposhtme origjinale ose kopje të certifikuar.

- Nëse keni shtetësi gjermane: pasaportën e vlefshme, letërnjoftimin e vlefshëm, dëshminë e natyralizimit
- Nëse keni shtetësi shqiptare: pasaportën e vlefshme shqiptare ose dëshminë e natyralizimit
- Nëse keni shtetësinë e një shteti tjetër: pasaportën e vlefshme, dëshminë e natyralizimit ose një dokument tjetër shtetësie

Pjesa B

(Kërkesa nëpërmjet një personi tjetër)

Nëse kërkesa nuk bëhet nga vetë përfituesi, por nga një person tjetër (p. sh. një person i autorizuar apo kujdestari), atëherë duhen shënuar të dhënat personale të këtij personi. Si dëshmi e autorizimit duhet paraqitur një prokurë, dëshmi emërimi ose librezë e kujdestarisë. Një librezë kujdestarie shqiptare duhet paraqitur bashkë me një letërnjoftim të vlefshëm të lëshuar nga autoritetet shqiptare.

Pjesa C

(Lloji i pensionit të kërkuar dhe fillimi i pensionit)

Këtu ju duhet të shënoni me kryq se çfarë pensioni kërkon nga Fondi Gjerman i Pensioneve. Se çfarë lloj pensionesh ekzistojnë dhe çfarë kriteresh duhen përmbushur, këtë do jua sqarojmë në vijim.

Periudhat e nevojshme minimale të sigurimit (kohët e pritjes dhe kohët e punësimit apo ushtrimit të profesionit) mund të përmbushen nga bashkimi i periudhave të sigurimit në Gjermani, Shqipëri dhe një shteti anëtar të BE-së, ZEE-së dhe Zvicrës. Kur është e nevojshme, merren në konsideratë edhe periudhat e sigurimit, të cilat janë përmbushur në një vend me të cilin Republika e Shqipërisë dhe Republika Federale e Gjermanisë kanë lidhur një marrëveshje të mbrojtjes shoqërore. Ato aktualisht janë Republika e Maqedonisë dhe Republika e Turqisë.

E drejta për pensione të caktuara gjermane (p.sh. pensioni për shkak të aftësisë së kufizuar) ndër të tjera kërkon që brenda një periudhe të caktuar të jetë përmbushur një numër i caktuar kontributesh apo të ashtuquajturat pritshmëri përfitimesh, ku periudha zgjatet për arsye të ndryshme (arsye të shtyrjes).

Këto fakte shqiptare janë të barabarta me faktet zgjatëse apo periudhat e pritshmërisë së përfitimit gjerman:

- Periudhat e marrjes së një pensioni shqiptar, invaliditeti apo pleqërie,
- Periudhat e marrjes së përfitimeve shqiptare për shkak të sëmundjes, barrë lindjes, papunësisë ose aksidenteve në punë (përfshijtur pensionet),
- Periudhat shqiptare të kujdesit ndaj fëmijëve.

Punkt 11 (Staatsangehörigkeit)

Als Nachweis Ihrer aktuellen Staatsangehörigkeit legen Sie bitte eine der nachstehend genannten Unterlagen im Original oder in beglaubigter Kopie vor.

- Sofern Sie die deutsche Staatsangehörigkeit besitzen: gültigen Reisepass, gültigen Personalausweis, Einbürgerungsurkunde
- Sofern Sie die albanische Staatsangehörigkeit besitzen: gültigen albanischen Reisepass oder Einbürgerungsurkunde
- Sofern Sie die Staatsangehörigkeit eines anderen Staates besitzen: gültigen Reisepass, Einbürgerungsurkunde oder einen anderen Nachweis der Staatsangehörigkeit

Teil B

(Antragstellung durch andere Person)

Wird der Antrag nicht von dem Rentenberechtigten selbst, sondern von einer anderen Person (z. B. einem Bevollmächtigten, Vormund, Betreuer) gestellt, sind hier die Personalien dieser Person einzutragen. Als Nachweis der Berechtigung ist z. B. eine Vollmacht, Bestallungsurkunde oder der Betreuerausweis vorzulegen. Ein albanischer Betreuerausweis ist zusammen mit einem von einer Regierungsbehörde ausgestellten rechtsgültigen Ausweis vorzulegen.

Teil C

(Beantragte Rentenart und Rentenbeginn)

In diesem Teil müssen Sie ankreuzen, welche Rente Sie aus der deutschen Rentenversicherung beantragen. Welche Renten es gibt und welche Voraussetzungen vorliegen müssen, nennen wir Ihnen nachstehend.

Die erforderlichen Mindestversicherungszeiten (Wartezeiten und Zeiten der Beschäftigung und Tätigkeit) können durch Zusammenrechnung mit Versicherungszeiten in Deutschland, Albanien sowie einem Mitgliedstaat der EU, des EWR sowie der Schweiz erfüllt werden. Soweit erforderlich, werden auch Versicherungszeiten, die Sie in einem Staat zurückgelegt haben, mit dem die Republik Albanien und die Bundesrepublik Deutschland ein entsprechendes Sozialversicherungsabkommen abgeschlossen haben, berücksichtigt. Das sind zurzeit die Republik Mazedonien und die türkische Republik.

Der Anspruch auf bestimmte deutsche Renten (z. B. die Rente wegen Erwerbsminderung) setzt unter anderem auch voraus, dass innerhalb eines festgelegten Zeitraums eine bestimmte Anzahl von Beiträgen oder sogenannte Anwartschaftserhaltungszeiten vorhanden sind, wobei sich der Zeitraum um verschiedene Tatbestände verlängert (sogenannte Verlängerungstatbestände).

Folgende albanische Tatbestände sind deutschen Verlängerungstatbeständen bzw. Anwartschaftserhaltungszeiten gleichgestellt:

- Zeiten des Bezuges einer albanischen Invaliditäts- oder Altersrente,
- Zeiten des Bezugs von albanischen Leistungen wegen Krankheit, Schwangerschaft, Mutterschaft, Arbeitslosigkeit oder Arbeitsunfällen (mit Ausnahme der Renten)
- Zeiten der Kindererziehung in Albanien.

Pika 1 (Pensionet e pleqërisë)

Nga fondi gjerman i pensioneve ka lloje të ndryshme pensionesh, të cilat parashtrijnë kushte të ndryshme për përfitimin e të drejtës për to. Në vijim do të shpjegohen llojet e ndryshme të pensioneve të pleqërisë.

Të gjitha pensionet e pleqërisë, përpara arritjes së kufirit ligjor të moshës, mund të merren si pension i plotë ose i pjesshëm. Pjesa e pensionit mund të zgjidhet sipas dëshirës, për sa kohë ajo është sa 10% e pensionit të plotë. Pensioni i pjesshëm mund të përfitohet maksimalisht deri në shumën e llogaritur, pasi janë marrë parasysh edhe të ardhurat shtesë. (shih shpjegimet në pikën 6).

Pensionit standard i pleqërisë

Këtë pension ju mund ta kërkonit, në qoftë se ju keni arritur moshën standarde të pensionit dhe keni përmbushur periudhën e përgjithshme pritëse prej pesë vjetësh. Përveç këtij pension ju mund të ushtroni pa kufizime punësimin apo profesionin.

Mosha e daljes në pension do të rritet gradualisht në 67. Nëse keni lindur në vitet nga 1947 deri në 1963, mosha standarde e pensionit rritet me hapa mujore dhe që nga viti 2024 me hapa dy-mujore. Nëse keni lindur pas datës 31.12.1963, mosha e daljes në pension është 67 vjeç.

Punkt 1 (Altersrenten)

Aus der deutschen Rentenversicherung gibt es verschiedene Arten von Altersrenten mit jeweils unterschiedlichen Anspruchsvoraussetzungen. Nachfolgend werden die einzelnen Altersrenten erläutert.

Alle Altersrenten vor Erreichen der Regelaltersgrenze können Sie als Vollrente oder als Teilrente beziehen. Der Anteil kann beliebig gewählt werden, solange er mindestens 10 % der Vollrente beträgt. Die Teilrente kann höchstens in der Höhe in Anspruch genommen werden, die sich nach der Anrechnung eines Hinzuverdienstes ergibt (siehe auch die Erläuterungen zu Punkt 6).

Regelaltersrente

Diese Altersrente können Sie beanspruchen, wenn Sie die Regelaltersgrenze erreicht und die allgemeine Wartezeit von fünf Jahren erfüllt haben. Neben dieser Altersrente können Sie uneingeschränkt eine Beschäftigung oder Tätigkeit ausüben.

Die Regelaltersgrenze wird stufenweise auf das 67. Lebensjahr angehoben. Sind Sie in den Jahren 1947 bis 1963 geboren, steigt die Regelaltersgrenze zunächst in Monats-, ab 2024 in Zwei-Monatsschritten. Sind Sie nach dem 31.12.1963 geboren, liegt die Regelaltersgrenze bei 67 Jahren.

I siguruari Viti i lindjes	Rritja me ... muaj	Në moshën	
		Viti	Muaji
Versicherter Geburtsjahr	Anhebung um ... Monat(e)	Jahr	Monat(e)
1947	1	65	1
1948	2	65	2
1949	3	65	3
1950	4	65	4
1951	5	65	5
1952	6	65	6
1953	7	65	7
1954	8	65	8
1955	9	65	9
1956	10	65	10
1957	11	65	11
1958	12	66	0
1959	14	66	2
1960	16	66	4
1961	18	66	6
1962	20	66	8
1963	22	66	10
Që nga / ab 1964	24	67	0

Pension i pleqërisë për të siguruarit afat-gjatë

Këtë pension ju mund ta kërkonti, në qoftë se ju keni arritur kufirin vendimtar të moshës dhe plotësoni periudhën e vjetërsisë prej 35 vjetësh. Ushtrimi i aktivitetit të punës apo profesionit mund të ushtrohet vetëm i kufizuar (shiko shënimet në pikën 6).

Nëse keni lindur që nga viti 1964, kufiri i moshës është 67 vjeç. Kërkesa për pension të parakohshëm, që me mbushjen e moshës 63 vjeçare, ka si pasojë një reduktim më të madh.

Altersrente für langjährig Versicherte

Diese Altersrente können Sie beanspruchen, wenn Sie die maßgebliche Altersgrenze erreicht und die Wartezeit von 35 Jahren erfüllt haben. Eine Beschäftigung oder Tätigkeit darf zunächst nur eingeschränkt ausgeübt werden (siehe Erläuterungen zu Punkt 6).

Wurden Sie ab 1964 geboren, liegt die Altersgrenze bei 67 Jahren. Eine vorzeitige Inanspruchnahme ab Vollendung des 63. Lebensjahres ist dann mit einem höheren Abschlag verbunden.

I siguruari Muaji ose viti i lindjes	Rritja e kufirit të moshës me ... muaj	Fillimi i ardhshëm i pensionit		Reduktimi nëse pensioni fillon në moshën 63 vjeçare në %
		Në moshën	muaj	
Versicherter Geburtsmonat bzw. Geburtsjahr	Anhebung der Altersgrenze um ... Monat(e)	künftiger normaler Rentenbeginn mit Jahren	Monat(en)	Abschlag bei Rentenbeginn mit 63 in %
janar / Jan 1949	1	65	1	7,5
shkurt / Feb 1949	2	65	2	7,8
Mars - dhjetor / März - Dez 1949	3	65	3	8,1
1950	4	65	4	8,4
1951	5	65	5	8,7
1952	6	65	6	9,0
1953	7	65	7	9,3
1954	8	65	8	9,6
1955	9	65	9	9,9
1956	10	65	10	10,2
1957	11	65	11	10,5
1958	12	66	0	10,8
1959	14	66	2	11,4
1960	16	66	4	12,0
1961	18	66	6	12,6
1962	20	66	8	13,2
1963	22	66	10	13,8
Që nga / ab 1964	24	67	0	14,4

Pension pleqërie për të siguruarit shumë afatgjatë

Këtë pension ju mund ta kërkonti pa zbritje, nëse ju jeni të paktën 63 vjeç dhe keni përmbushur periudhën e vjetërsisë prej 45 vitësh. Punësimi ose profesioni mund të ushtrohet fillimisht vetëm i kufizuar (shiko shënimet në pikën 6). Për të siguruarit e lindur që nga viti 1953, kufiri i moshës nga 63 vjeç rritet si vijon:

Altersrente für besonders langjährig Versicherte

Diese Altersrente können Sie ohne Rentenabschläge beanspruchen, wenn Sie mindestens 63 Jahre alt sind und die Wartezeit von 45 Jahren erfüllt haben. Eine Beschäftigung oder Tätigkeit darf zunächst nur eingeschränkt ausgeübt werden (siehe Erläuterungen zu Punkt 6). Für Versicherte, die ab 1953 geboren sind, wird die Altersgrenze von 63 Jahren wie folgt angehoben:

I siguruari Viti i lindjes	Rritja me ... muaj	Në moshën	
		Viti	muaj
Versicherter Geburtsjahr	Anhebung um ... Monate	Jahr	Monate
1953	2	63	2
1954	4	63	4
1955	6	63	6
1956	8	63	8
1957	10	63	10
1958	12	64	0
1959	14	64	2

I siguruari Viti i lindjes	Rritja me ... muaj	Në moshën	
		Viti	muaj
Versicherter Geburtsjahr	Anhebung um ... Monate	auf das Alter	
		Jahr	Monate
1960	16	64	4
1961	18	64	6
1962	20	64	8
1963	22	64	10
Që nga / ab 1964	24	65	0

Periudha të caktuara papunësie (periudhat e marrjes së asistencës nga papunësia ose ndihmës ekonomike për shkak papunësie) si edhe periudhat e kompensimit ose ndarjes së pensioneve (splitting) nuk do të merren në konsideratë për 45 vitet. Periudhat e përfitimit të asistencës së papunësisë në dy vitet e fundit para daljes në pension merren në konsideratë vetëm nëse ato janë rezultat i falimentit ose mbylljes së aktivitetit të punëdhënësit. Kontributet vullnetare konsiderohen vetëm nëse janë përmbushur të paktën 18 vjet me kontribute të detyrueshme.

Pension pleqërie për persona me aftësi të kufizuar rëndë

Këtë pension pleqërie mund ta kërkonte, në qoftë se ju keni arritur kufirin e moshës përkatëse dhe plotësoni periudhën kualifikuese prej 35 vjetësh dhe në fillim të pensionit njiheni si person me aftësi të kufizuar të rëndë në kuptimin e Kodit Social gjerman (§ 2 parag. 2 SGB IX). Nëse keni lindur para vitit 1951, në vend të aftësisë së kufizuar rëndë, mjafton edhe paaftësia për punë. Nëse ju aplikoni për pension për shkak të shfaqjes së paaftësisë në punë, ju lutemi të plotësoni edhe pjesën „L“ të formularit të aplikimit. Në këtë rast punësimi ose profesioni fillimisht mund të ushtrohet vetëm i kufizuar (shiko shënimet në pikën 6).

Nëse keni lindur nga viti 1952 deri në vitin 1963, kufiri i moshës prej 63 vjetësh rritet gradualisht. Në këtë mënyrë shtyhet edhe pensioni i parakohshëm me zbritje. Nëse keni lindur që nga viti 1964, kufiri i moshës është 65 vjeç dhe ju mund të merrni pension të parakohshëm në moshën 62 vjeçare dhe një zbritje prej 10,8%.

Bestimmte Zeiten der Arbeitslosigkeit (Zeiten des Bezugs von Arbeitslosengeld II oder Arbeitslosenhilfe) und Zeiten aus dem Versorgungsausgleich oder Rentensplitting werden für die 45 Jahre nicht berücksichtigt. Zeiten des Bezugs von Arbeitslosengeld in den letzten zwei Jahren vor Rentenbeginn zählen nur mit, wenn diese Folge einer Insolvenz oder vollständigen Geschäftsaufgabe des Arbeitgebers sind. Freiwillige Beiträge werden nur berücksichtigt, wenn mindestens 18 Jahre mit Pflichtbeiträgen vorhanden sind.

Altersrente für schwerbehinderte Menschen

Diese Altersrente können Sie beanspruchen, wenn Sie die maßgebliche Altersgrenze erreicht und die Wartezeit von 35 Jahren erfüllt haben sowie bei Beginn der Rente als schwerbehinderter Mensch im Sinne des deutschen Sozialgesetzbuches (§ 2 Abs. 2 SGB IX) anerkannt sind. Sind Sie vor 1951 geboren, genügt statt der Schwerbehinderung auch eine Berufs- oder Erwerbsunfähigkeit. Falls Sie die Altersrente wegen des Vorliegens von Berufs- oder Erwerbsunfähigkeit beantragen, füllen Sie bitte auch Teil L im Antragsvordruck aus. Eine Beschäftigung oder Tätigkeit darf zunächst nur eingeschränkt ausgeübt werden (siehe Erläuterungen zu Punkt 6).

Wurden Sie 1952 bis 1963 geboren, wird die Altersgrenze von 63 Jahren stufenweise angehoben. Dadurch verschiebt sich auch der vorzeitige Beginn mit Abschlag. Wurden Sie ab 1964 geboren, liegt die maßgebliche Altersgrenze bei 65 Jahren und Sie können die Rente vorzeitig mit 62 Jahren und einem Abschlag von 10,8 % in Anspruch nehmen.

I siguruari Muaji ose viti i lindjes	Rritja e moshës së pensionit me muaj	Fillimi normal i pensionit		Fillimi i parakohshëm i pensionit me zbritje prej 10,8 %	
		Në moshën	muaj	Në moshën	muaj
Versicherter Geburtsmonat bzw. Geburtsjahr	Anhebung der Altersgrenze um ... Monat(e)	künftiger normaler Rentenbeginn		frühestmöglicher Rentenbeginn mit 10,8 % Abschlag	
		mit Jahren	Monat(en)	mit Jahren	Monat(en)
janar / Jan 1952	1	63	1	60	1
shkurt / Feb 1952	2	63	2	60	2
mars / März 1952	3	63	3	60	3
prill / April 1952	4	63	4	60	4
maj / Mai 1952	5	63	5	60	5
qershor - dhjetor / Juni - Dez 1952	6	63	6	60	6
1953	7	63	7	60	7
1954	8	63	8	60	8
1955	9	63	9	60	9
1956	10	63	10	60	10

I siguruari Muaji ose viti i lindjes	Rritja e moshës së pensionit me muaj	Fillimi normal i pensionit		Fillimi i parakohshëm i pensionit me zbritje prej 10,8 %	
		Në moshën	muaj	Në moshën	muaj
Versicherter Geburtsmonat bzw. Geburtsjahr	Anhebung der Altersgrenze um ... Monat(e)	künftiger normaler Rentenbeginn		frühestmöglicher Rentenbeginn mit 10,8 % Abschlag	
		mit Jahren	Monat(en)	mit Jahren	Monat(en)
1957	11	63	11	60	11
1958	12	64	0	61	0
1959	14	64	2	61	2
1960	16	64	4	61	4
1961	18	64	6	61	6
1962	20	64	8	61	8
1963	22	64	10	61	10
Që nga / ab 1964	24	65	0	62	0

Pension pleqërie për minatorët e punësuar në nëntokë

Këtë pension ju mund ta kërkonti, kur të keni arritur kufirin përkatës të moshës dhe të keni përbushur periudhën kualifikuese prej 25 vjetësh si i punësuar me punë të përhershme nëntokësore.

25 viteve si i punësuar me punë të përhershme nëntokësore i bashkohen edhe periudhat e sigurimit si minator i punësuar në nëntokë në Shqipëri.

Punësimi ose profesioni fillimisht mund të ushtrohet vetëm i kufizuar (shiko shënimet në pikën 6).

Nëse keni lindur nga viti 1952 deri në vitin 1963, kufiri i moshës prej 60 vjetësh rritet gradualisht. Nëse keni lindur që nga viti 1964, kufiri i moshës është 62 vjeç.

Pika 2 (Pension për arsye invaliditeti)

Këto pensione janë

- Pension për arsye të invaliditetit të plotë ose të pjesshëm
- Pension për minatorët

Këto pensione mund t'i kërkonti para se të arrini moshën standarde të daljes në pension (shih pikën 1 tek pensioni standard), nëse aftësia juaj për punë është e kufizuar. Nëse j' u paguhet një pension i pjesshëm ose i plotë invaliditeti, kjo varet nga vëllimi i punës të cilën jeni të aftë të kryeni.

Gjithashtu, kusht është që para fillimit të invaliditetit të jetë përbushur periudha e kualifikimit prej 5 vitesh dhe në 5 vitet e fundit përpara fillimit të invaliditetit të jenë derdhur tre vite kontribute të detyrueshme. Periudhat e kontributeve në Shqipëri ose në një nga Shtetet përmendur pjesën C, ku është ushtruar punësimi apo profesioni, janë të barabarta me periudhat gjermane të kontributeve të detyrueshme. Periudha 5 vjeçare mund të zgjatet me periudhat gjermane të llogaritjes, ato të marra në konsideratë dhe atyre zëvendësuese si edhe me arsyet e shtyrjes sipas legjisllacionit shqiptar.

Altersrente für langjährig unter Tage beschäftigte Bergleute

Diese Altersrente können Sie beanspruchen, wenn Sie die maßgebliche Altersgrenze erreicht und die Wartezeit von 25 Jahren aufgrund einer Beschäftigung mit ständigen Arbeiten unter Tage erfüllt haben.

Auf die erforderlichen 25 Jahre aufgrund einer Beschäftigung mit ständigen Arbeiten unter Tage werden auch entsprechende Pflichtbeitragszeiten als Bergmann aufgrund einer Beschäftigung unter Tage in Albanien angerechnet.

Eine Beschäftigung oder Tätigkeit darf zunächst nur eingeschränkt ausgeübt werden (siehe Erläuterungen zu Punkt 6).

Wurden Sie 1952 bis 1963 geboren, wird die Altersgrenze von 60 Jahren stufenweise angehoben. Wurden Sie ab 1964 geboren, liegt die maßgebliche Altersgrenze bei 62 Jahren.

Punkt 2 (Rente wegen Erwerbsminderung)

Diese Renten sind die

- Rente wegen teilweiser oder voller Erwerbsminderung,
- Rente für Bergleute.

Diese Renten können Sie vor Erreichen der Regelaltersgrenze (siehe zu Punkt 1 unter Regelaltersrente) beantragen, wenn Ihre Erwerbsfähigkeit eingeschränkt ist. Ob Ihnen eine Rente wegen teilweiser oder wegen voller Erwerbsminderung gezahlt wird, hängt vom Umfang der noch möglichen Erwerbstätigkeit ab.

Voraussetzung ist außerdem, dass vor Eintritt der Erwerbsminderung die allgemeine Wartezeit von fünf Jahren erfüllt ist und in den letzten fünf Jahren vor Eintritt der Erwerbsminderung drei Jahre Pflichtbeitragszeiten vorliegen. Beitragszeiten in Albanien oder in einem der im Teil C genannten Staaten, in denen eine Beschäftigung oder Tätigkeit ausgeübt wurde, stehen den deutschen Pflichtbeitragszeiten gleich. Der Zeitraum von 5 Jahren kann sich um deutsche Anrechnungs-, Berücksichtigungs- und Ersatzzeiten sowie um Zeiten des Bezuges einer deutschen Erwerbsminderungsrente und um bestimmte Verlängerungstatbestände nach albanischem Recht verlängern.

Lidhur me pensionin për minatorët, ketu merren në konsideratë vetëm periudhat e kontributeve të detyrueshme në arkën e fondit përkatës të minatorëve. Këtu përfshihen edhe periudhat shqiptare të kontributeve shqiptare, në të cilën është ushtruar profesioni i minatorit në nëntokë.

Nëse në periudhën pesëvjeçare nuk janë përmushur tre vjet periudha të kontributit të detyrueshëm ose periudha të barabarta me to në Shqipëri apo në një Shtet tjetër nga pjesa „C“, e drejta për pension mbetet ekzistente nëse periudha e kualifikimit prej 5 vitesh është përbushur para datës 01.01.1984 dhe periudha që nga data 01.01.1984 është mbuluar pa ndërprerje nga periudha gjermane ose shqiptare e sigurimit.

Lidhur me punësimin ose ushtrimin e profesionit gjatë invaliditetit, ju lutemi t'ju referoheni shpjegimeve në pjesën „L“.

Pika 3 (Pensioni për edukimin e fëmijëve)

E drejta për këtë pension ekziston deri në mbushjen e moshës së pensionit, nëse

- Martesa juaj është zgjidhur pas datës 30 qershor 1977,
- Bashkëshorti juaj i divorcuar nuk jeton më,
- Jeni duke rritur një fëmijë ose kujdeseni për një fëmijë raketik,
- Nuk jeni martuar më,
- Deri në vdekjen e bashkëshortit tuaj të divorcuar ju keni përbushur periudhën e kualifikimit prej 5 vitesh.

Pensionit të edukimit i llogariten të ardhurat personale, përsa kohë është tejkualuar shuma e lejuar.

Pika 4 (Fillimi i pensionit të pleqërisë)

Siç është pasqyruar në pikën 1, kufiri i moshës ngrihet gradualisht. Për shkak të skemës së ligjshme, disa pensione pleqërie mund të fillojnë më herët (gjithsesi me zbritje). Ndaj ju lutemi t'ju përgjigjeni patjetër edhe pyetjeve nga pika 6 deri në 8 të pjesës „D“.

Ju këtu mund të specifikoni nëse doni të kërkonte pension pleqërie në rastin e parë të mundshëm, **me ose pa** reduktime. Ju gjithashtu mund ta specifikoni vetë **kohën**, duke mënjanuar kështu reduktimin e pensionit ose duke përfituar shtesa në pensionin standard të pleqërisë.

Si data e dëshiruar e fillimit të pensionit duhet shënuar gjithmonë data e parë e muajit ku dëshirohet fillimi i pensionit.

Pika 5 (Përfundimi i punësimit dhe ushtrimit të profesionit)

E drejta për një pension pleqërie si pension i plotë, (shih pikën 1 në bazë të pensionit Standard), qëndron vetëm nëse ju nuk e kaloni kufirin e të ardhurave shtesë prej 6.300 euro bruto në një vit kalendarik.

Bei der Rente für Bergleute können für die genannten Voraussetzungen ausschließlich knappschaftliche Pflichtbeitragszeiten berücksichtigt werden. Hierzu zählen auch albanische Beitragszeiten, in denen eine Beschäftigung als Bergmann unter Tage ausgeübt wurde.

Sind im Fünfjahreszeitraum keine drei Jahre Pflichtbeitragszeiten oder gleichgestellte Beitragszeiten in Albanien oder in einem der im Teil C genannten Staaten vorhanden, so besteht auch dann ein Anspruch, wenn vor dem 01.01.1984 die allgemeine Wartezeit von fünf Jahren erfüllt war und die Zeit vom 01.01.1984 an durchgehend mit deutschen rentenrechtlichen Zeiten oder albanischen Beitragszeiten belegt ist.

Hinsichtlich einer Beschäftigung oder Tätigkeit während der Erwerbsminderung verweisen wir auf die Erläuterungen im Teil L.

Punkt 3 (Erziehungsrente)

Ein Anspruch auf diese Rente besteht bis zum Erreichen der Regelaltersgrenze, wenn

- Ihre Ehe nach dem 30. Juni 1977 geschieden ist,
- Ihr geschiedener Ehegatte gestorben ist,
- Sie ein Kind erziehen oder für ein gebrechliches Kind sorgen,
- Sie nicht wieder geheiratet haben und
- bis zum Tod Ihres geschiedenen Ehegatten die allgemeine Wartezeit von fünf Jahren erfüllt ist.

Auf die Erziehungsrente wird eigenes Einkommen angerechnet, soweit ein bestimmter Freibetrag überschritten wird.

Punkt 4 (Beginn der Altersrente)

Wie zu Punkt 1 dargestellt, werden die Altersgrenzen stufenweise angehoben. Aufgrund einer Vertrauensschutzregelung kann es bei einigen Altersrenten zu einem früheren Rentenbeginn als dargestellt kommen (allerdings mit Abschlägen). Beantworten Sie daher unbedingt auch die Fragen 6 bis 8 im Teil D.

Sie können hier angeben, ob Sie die beantragte Rente zum frühestmöglichen Zeitpunkt **mit oder ohne** Rentenabschläge beanspruchen wollen. Sie können aber auch einen von Ihnen gewählten **Zeitpunkt** angeben, dadurch können sich die Rentenabschläge vermindern oder bei der Regelaltersrente sogar Zuschläge ergeben.

Als Zeitpunkt des gewünschten Beginns der Altersrente ist immer der Erste des Monats anzugeben, von dem an die Rentenzahlung gewünscht wird.

Punkt 5 (Aufgabe der Beschäftigungen und Tätigkeiten)

Anspruch auf eine Altersrente als Vollrente besteht vor Erreichen der Regelaltersgrenze (siehe zu Punkt 1 unter Regelaltersrente) nur, wenn Sie die kalenderjährliche Hinzuverdienstgrenze von 6.300 EUR brutto nicht überschreiten.

Pika 6 (Të ardhurat shtesë të pensionit të pleqërisë)

Nëse tejkalohet kufiri i të ardhurave shtesë të përcaktuara në pikën 5, nuk ekziston më e drejta për pension pleqërie si pension i plotë. Ne do të verifikojmë nëse ai mund të paguhet si pension i pjesshëm. Pensioni dhe të ardhurat shtesë nuk lejohet të jenë gjithësej më të larta se të ardhurat tuaja para përfitimit të pensionit. E drejta juaj për pension rrëzohet, nëse ju fitoni shumë të ardhura shtesë.

Shuma e pensionit të pleqërisë para se të arrihet kufiri i moshës për të dalë në pension, përcaktohet në fillim në bazë të një parashikimi (prognoze) për të ardhurat shtesë të një viti kalendarik. Kjo prognozë krahasohet pastaj me vonë me të ardhurat faktike. Pagesa e pensionit korrigojohet me efekt në të kaluarën, nëse duhet. Kështu juve mund t'ju paguhet pjesa shtesë sipas llogaritjes, por nesë keni marrë më shumë pension, atëherë duhet që atë pjesë ta ktheni përsëri. Nëse ju jeni dakord, ne mbajmë për një shumë të paguar tepër deri në 200 euro prej pensionit tuaj. Maksimalisht mbahet gjysma e pensionit.

Pjesa D (Të dhëna plotësuese mbi të siguarin)

Pikat 1 dhe 2 (Vendbanimi i fundit në Gjermani dhe largimi nga Gjermania)

Kjo është me rëndësi për personat e siguar, të cilët kanë pëmbushur periudha sigurimi sipas ligjeve të Rajhu-t (p. sh. në Prusinë Lindore) ose periudha sigurimi sipas një ligji të huaj (p. sh. në Rusi apo Hungari). Pensioni nga këto periudha sigurimi ju paguhet në të njëjtën vlerë sikur të ishin pëmbushur periudha sigurimi në territorin e Republikës Federale. Kusht këtu është që personi i siguar të ketë lindur përpara datës 19.05.1950 dhe ta ketë patur vendbanimin e zakonshëm jashtë shtetit përpara datës 19.05.1990.

Për më tepër, këto pika janë të rëndësishme për verifikimin se si duhen vlerësuar periudhat e sigurimit të pëmbushura në ish-RDGJ dhe dhe periudhat e kontributeve të Rajhut dhe se deri në cilin afat duhen llogaritur periudhat e kujdesit ndaj fëmijëve.

Pika 3 (Numri personal gjerman i identifikimit për qëllime tatimore)

Fondi Gjerman i Pensioneve është i detyruar t'i raportojë Autoritetit Qendror për Subvencionet e Pensioneve të Pleqërisë" (ZfA) të gjitha pensionet e paguara vjetore. Pra, nëse j'u është bërë me dije nga Zyra Qendrore Federale e Tatimeve gjermane numri personal i identifikimit, ju lutemi ta shënoni.

Pika 4 (Statusi i të përndjekurit)

Personat që kanë qenë të përndjekur nën sundimin e nazizmit apo të socializmit, në rrethana të caktuara kanë të drejtë për një pension më të lartë. Prandaj, ju lutemi shënoni nëse i përkisni këtij grupi. Lutemi bashkëlidhni dokumentacionin.

Punkt 6 (Hinzuverdienst zur Altersrente)

Wird die zu Punkt 5 genannte Hinzuverdienstgrenze überschritten, besteht kein Anspruch mehr auf die Altersrente als Vollrente. Wir prüfen jedoch, ob sie als Teilrente gezahlt werden kann. Rente und Hinzuverdienst dürfen insgesamt nicht höher sein, als Ihr Einkommen vor dem Rentenbezug. Der Rentenanspruch entfällt, wenn Sie zu viel hinzuverdienen.

Die Höhe der Altersrente vor Erreichen der Regelaltersgrenze wird zunächst aufgrund einer vorausschauenden Betrachtung (Prognose) des kalenderjährlichen Hinzuverdienstes festgestellt. Diese Prognose wird später mit dem tatsächlichen Verdienst verglichen. Die Rentenzahlung wird gegebenenfalls rückwirkend korrigiert. Daraus kann sich eine Nachzahlung für Sie ergeben, zu viel gezahlte Beträge müssen Sie jedoch zurückzahlen. Wenn Sie damit einverstanden sind, behalten wir einen zu viel gezahlten Betrag von bis zu 200 EUR von der laufenden Rente ein. Höchstens wird dabei die halbe Rente einbehalten.

Teil D (Ergänzende Angaben zum Versicherten)

Punkte 1 und 2 (Letzter deutscher Wohnsitz bzw. Verlassen Deutschlands)

Dies ist zunächst für Versicherte von Bedeutung, die reichsgesetzliche Beitragszeiten (z. B. in Ostpreußen) oder Beitragszeiten nach dem Fremdrengengesetz (z. B. in Russland oder Ungarn) zurückgelegt haben. Ihnen kann die Rente aus diesen Beitragszeiten in dem gleichen wertmäßigen Umfang gezahlt werden, in dem Bundesgebiets-Beitragszeiten vorliegen. Voraussetzung hierfür ist, dass der Versicherte vor dem 19.05.1950 geboren ist und sich bereits vor dem 19.05.1990 gewöhnlich im Ausland aufgehalten hat.

Ferner sind diese Punkte für die Prüfung von Bedeutung, wie im Gebiet der ehemaligen DDR und im Reichsgebiet zurückgelegte Beitragszeiten zu bewerten sind und bis zu welchem Zeitpunkt Zeiten der Kindererziehung angerechnet werden können.

Punkt 3 (Deutsche persönliche Identifikationsnummer für steuerliche Zwecke)

Der deutsche Rentenversicherungsträger ist verpflichtet, die gezahlten Rentenbeträge jährlich der Zentralen Zulagenstelle für Altersvermögen (ZfA) zu melden. Sofern Ihnen dazu vom deutschen Bundeszentralamt für Steuern bereits eine persönliche Identifikationsnummer mitgeteilt wurde, geben Sie diese bitte an.

Punkt 4 (Verfolgte Eigenschaft)

Personen, die unter Herrschaft des Nationalsozialismus oder des Sozialismus verfolgt worden sind, haben unter bestimmten Voraussetzungen einen Anspruch auf eine höhere Rente. Bitte geben Sie daher an, ob Sie zu diesen Personen gehören. Vorhandene Unterlagen sind beizufügen.

Pika 5 (Statusin e të debuarit apo refugjatit)

Këtu bëhet fjalë për persona të debuar apo refugjatë në kuptim të Ligjit Gjerman të Dëbimit. Këta janë persona, të cilët pas Luftës së Dytë Botërore, si shtetas apo populli gjerman, u debuan kryesisht nga vendet e Bollkut të Lindjes. Refugjatët janë ata që janë larguar nga ish-RDGJ dhe Berlina (Lindor) për shkak të kushteve të atjeshme sunduese të politikës. Nëse dispononi një librezë (dëshmi) të debuari apo refugjati, atë duhet t'ja bashkëlidhni kërkesës së pensionit.

Pika 6 (Mbrojtja shoqërore)

